



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 01/2018

I mbajtur në Komitetin për Komunitete të dates 12.02.2018

Rendi i ditës:

- 1-Konfirmimi i pjesëmarrjes së anëtarëvetë Komitetit për komunitete;
- 2-Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për komunitete;
- 3-Pyetje dhe kërkesa;
- 4-Të ndryshme.

Mbledhja filloi në ora 10:05 me praninë e Kryesueses së kuvendit të komunës znj Kristina Gashi Bytyci dhe të anëtarëve, përvec znj.Zorica Kostic

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës Kristina Gashi Bytyci e hapi mbledhjen, duke paraqitur rendin e ditës. Pas konfirmimit të pjesëmarrësve ajo tha se për Komitetin e Komiteteve janë zgjedhur katër anëtarë nga partitë politike që marrin pjesë në kuvendin e Komunës, kurse pesë të tjerë janë nga komunitetet. Lidhur me zgjedhjen e kryesuesit, z.Hajriz Haziri propozoi që kryesues i komitetit për komunitete të jetë Xhemajl Jashari. Nuk pati propozime të tjera. Komiteti njëzëri votoi që z.Xhemajl Jashari të jetë kryetar.

Në pikën të ndryshme- Esat Shatrolli kërkoi që komiteti të zgjedhë një anëtar për KKSB dhe me votë të njëzëshme për këtë detyrë u zgjodh znj.Mimoza Sojeva Pajaziti.

Procesmbajtësi

Musli Berisha

Kryesuesja Kuvendit

Kristina Gashi Bytyci